




|                                                                                                            |                                                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES<br>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                                   |
| Dep.<br>Dep. <u>2-D/DPK</u>                                                                                | Nr Prot.<br>B-Prot<br>Prot No <u>01-2097/2012</u> |
| Nr i ttau<br>Broj stranica<br>Nr. pages <u>02</u>                                                          | Data<br>Datum<br>Dat <u>13.06.2012</u>            |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.06.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-4813/11,për Zyrtarin e Lartë z.Leonard Shehu, Anëtar i Bordit te Drejtoreve ne Kompaninë Regjionale te Ujesjellsit “ Radoniqi” Gjakove, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas informatës se marre gjate kontrollit te formularit për deklarim te pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK–03-4813/11,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Leonard Shehu, Anëtar i Bordit te Drejtoreve ne Kompaninë Regjionale te Ujesjellsit “ Radoniqi” Gjakove .

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Anëtar i Bordit te Drejtoreve ne K.R.U “ Radoniqi” ne Gjakove, ka qene i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si person i autorizuar dhe Drejtor ne biznesin, Shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar “C.M. Furniture Balkan” SH.P.K.” që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit

të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Leonard Shehu, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Kompaninë Regjionale të Ujësjetllësit "Radoniqi" në Gjakovë, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia.

Me datën 12.04.2012 z.Leonard Shehu, ka qenë në zyrat e AKK-se, ku nga zyrtaret e AKK-së, është njoftuar për situatën dhe për provat që disponojnë, si dhe është biseduar për gjendjen që mundet të shkaktoj konfliktin e mundshëm të interesit të paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, z.Leonard Shehu, gjatë takimit është pajtuar për situatën mirë po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar as kush se kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit. Dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

z.Leonard Shehu, është zotuar se në afatin ligjor do të bëjë ndryshimet në këto biznese, dhe do të largohet nga funksioni menaxhues si Drejtor dhe person i autorizuar në biznes, për ta shmangur gjithë dyshim që mundet të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit.

Me datën 28.05.2012, Zyrtari i lartë, z.Leonard Shehu, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Kompaninë Regjionale të Ujësjetllësit "Radoniqi" në Gjakovë ka sjellë dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku shihet se z.Leonard Shehu nuk ka me pozitën e drejtorit dhe personit të autorizuar në biznesin "C.M. Furniture Balkan" SH.P.K.

Andaj në bazë të dëshmimeve dhe fakteve konstatohet se :

Zyrtari i lartë z.Leonard Shehu, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Kompaninë Regjionale të Ujësjetllësit "Radoniqi" në Gjakovë, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej, pasi që nuk mbanë me pozitën e Drejtorit dhe personit të Autorizuar në biznesin "C.M. Furniture Balkan" SH.P.K.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri me funksionin publik si, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Kompaninë Regjionale të Ujësjetllësit "Radoniqi" në Gjakovë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

